



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Kryesia e Kuvendit

P-080

Prishtinë, më 7 janar 2017 (*e shtunë*), në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 7 JANAR 2017

Në mbledhje morën pjesë: Xhavit Haliti dhe Sabri Hamiti, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Zenun Pajaziti, Salih Morina, Glauk Konjufca, Pal Lekaj dhe Valdete Bajrami.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Avni Bytyçi dhe Valmir Klaiqi;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi Xhavit HALITI, nënkryetar i Kuvendit.

Kryesia, me propozim të kryesuesit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi i kërkesës për seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit

Kryesuesi i njoftoi të pranishmit se 43 deputetë të Kuvendit kanë parashtruar kërkesë për mbajtjen e një seance të jashtëzakonshme të Kuvendit me këtë pikë të rendit të ditës:

1. Debat parlamentar në lidhje me mbajtjen në arrest të kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, z. Ramush Haradinaj, në Francë

Kryesuesi i hapi diskutimet lidhur me kërkesën e lartshënuar për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme.

Fillimisht, kryetari i GP të AAK-së, z. Pal Lekaj, në emër të 43 deputetëve nënshkrues para anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit e paraqiti dhe e arsyeoi kërkesën për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme në lidhje me mbajtjen në arrest të kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, z. Ramush Haradinaj, në Francë, diskutimi i të është dhënë në transkript.

Më pas, kryetari i GP të PDK-së, z. Zenun Pajaziti, propozoi që seanca e jashtëzakonshme, e kërkuar nga 43 deputetë të Kuvendit në lidhje me mbajtjen në arrest të kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, z. Ramush Haradinaj, në Francë, të mbahet të martën më 10 janar 2017, me arsyetimin një numër i deputetëve të Kuvendit janë jashtë vendit.

Lidhur me propozimin e kryetarit të GP të PDK-së, Zenun Pajaziti, diskutuan: nënkryetarët e Kuvendit: Xhavit Haliti dhe Sabri Hamiti, dhe kryetarët e grupeve parlamentare: Salih Morina, Glauk Konjufca, Valdete Bajrami dhe Pal Lekaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, Kryesia, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare të pranishëm, vendosi që seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të mbahet më 10 janar 2017, në orën 11:00, me këtë:

Rend dite

1. Debat parlamentar në lidhje me mbajtjen në arrest të kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, z. Ramush Haradinaj, në Francë.

Kryesuesi e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 12:55 minuta.

Nënkryetari i Kuvendit
Xhavit HALITI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*